



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 17.03/2026
Numër Protokolli: 1381/2026

A.nr.211/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti, kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.211/2026 të datës 25.02.2026 të parashtruar nga ankuesja V.S nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Sekretariati i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në çështjen juridike “*Kontestim Konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 17.03.2026 mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës A.nr.211/2026 të datës 25.02.2026 të parashtruar nga ankuesja V.S.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, V.S (*tani e tutje referuar: ankuesja*), me datë 25.02.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimit për rezultatet përfundimtare i datës 27.01.2026 me numër protokolli 417/2026, në lidhje me procedurën e regrutimit me numër reference RN00019084, për pozitën e punës Zyrtar i lartë i Burimeve Njerëzore për shkak se sipas pretendimit të ankueses vlerësimi nuk ka qenë profesional sipas Ligjit për Shërbimin Civil dhe rregullores për emërimë në shërbimin civil, komisioni nuk ka qenë reprezentativ, profesional dhe i bazuar në ligj si dhe dyshon se kandidatët që kanë hy në test dhe janë zgjedhë nuk i kanë plotësue kushtet sikurse ankuesja.

Kolegji i Këshillit, nga shqyrtimi i provave të lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ lidhur me ankesën e ankueses, **sepse:**

Në procedurë të shqyrtimit të ankesës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.03.2026, ka pranuar shkresën përmes emailit drejtuar në emailin zyrtarë të Kryetarit të Kolegjit në lidhje me këtë lëndë përmes së cilës shkresë e njëjta ka tërhequr ankesën me numër protokolli 417/2026 të datës 25.02.2026.

Andaj, mbi bazën e këtyre rrethanave përkatësisht duke marrë parasysh shkresën e datës 16.03.2026 për tërheqje të ankesës në lidhje me ankesën A.nr.211/2026 të datës 25.02.2026, Kolegji i Këshillit konstatoi plotësimin e kushtit ligjor për përfundimin e procedimit administrativ siç parashihet në dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku parashihet: “*1.Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë*”, si dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.211/2026 të datës 25.02.2026.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda:A.nr.211/2026, datë 17/03/2026.

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses V.S; dhe
- Sekretariatit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës(Sekretarit të Përgjithshëm dhe Burimeve Njerëzore);
- Arkivit të KPMSHCK-së.